VENDIM
Nr.50, datë 27.1.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 599, DATË 31.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT SHKENCOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.599, datë 31.8.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:
"Për përbërjen e komisionit të vlerësimit të titujve akademikë".
2. Në shkronjën "b" të pikës 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
"- Prof. Dr. Myqerem Tafaj zëvendësohet me Prof. Dr. Aleks Luarasi;
- Prof. Dr. Mentor Petrela zëvendësohet me Prof. Dr. Nestor Tereska.".
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha